

**Drejtuar:** Operatori ekonomik “M.A.K Studio” shpk

**Adresa:** Njesia bashkiake nr.5, rruga Irfan Tomini, pallati i shoqerise Cani nr 1, Tiranë.

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Loti II: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i Emergjencës Civile-Shkarja Petrelë”.

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i Emergjencës Civile-Shkarja Petrelë”.

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-02697-08-12-2021

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

**Fondi limit:** 168,597 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2021, miratuar me me VKB Nr.81 datë 02.07.2021 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.172, datë 21.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021 (i ndryshuar)”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 24.08.2021, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.122 datë 16.08.2021.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “MCE” shpk**

**NUIS L72203065K**

Vlera e ofertës = **119,710.17** (njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dhjetë pikë shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**2. Operatori ekonomik “M.A.K Studio” shpk**

**NUIS L014220170**

Vlera e ofertës = **149,096** (njëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

**3. Operatori ekonomik “NOVATECH STUDIO” shpk**

**NUIS L1717030C**

Vlera e ofertës = **155,628** (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzetë e tetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit Operatori ekonomik janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtem:

**Operatori ekonomik “MCE” shpk**

**NUIS L72203065K**

Pas hapjes së ofertave, u konstatua se Operatori ekonomik ”MCE” shpk nuk plotëson pikën 1 (b) të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit ku thote Ofertuesi duhet të paraqesë: *b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*; Ky fakt i konstatuar u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.

Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik si dhe mungesa e *Sigurimit të Ofertës* u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 2, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur informojmë operatorin ekonomik “**M.A.K Studio**” shpk, me adresë: Njesia bashkiake nr.5, rruga Irfan Tomini, pallati i shoqërisë Cani nr 1, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **149,096** (njëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik.